



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 05.05.2025

Numër Protokolli: 3436/2025

A.nr.403/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.403/2025, të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi N.Z., kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 05.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e papabuar ankesa me numër A.nr.403/2025, e datës 03.03.2025, e parashtruar nga ankuesi N.Z.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 14-117/01-15936/25, i datës 04.02.2025, i Sektorit të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore, të Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, N. Z. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 03.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 14-117/01-15936/25, të datës 04.02.2025, të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore, të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 24.04.2025 ka përcjell provat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1377/2025 të datës 03.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës së datës 03.03.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e bashkangjitura të datës 24.04.2025; Akt emërimit Nr.01-112-837/2024 të datës 11.09.2024; Përshkrimin e detyrave të punës për ankuesin; Kërkesën e ankuesit drejtuar Komunës së Prishtinës të datës 30.01.2025; Vendimin me numër protokolli 14-117/01-15936 të datës 04.02.2025 të Sektorit të Burimeve Njerëzore, të Komunës së Prishtinës; Listën e pagave për periudhën 01-01-2024 deri më 31-12-2024; Vendimin me numër protokolli 14-101/03-109913/24 të datës 21.08.2025; Vendimin me numër

protokolli 01-070/01-0096082/17 të datës 05.05.2017; Akt emërimit AE/01 të datës 15.02.2013; Akt emërimit 01 Nr.112-817 të datës 01.02.2017; Vendimin e Kryetarit të Këshillit për shtyrjen e afatit të lëndës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është ***e pabazuar, sepse:***

Nga administrimi i provave të lëndës del së ankuesi fillimisht sipas Akt emërimit me numër 01-112-837 të datës 15.02.2013, ka qenë i emëruar në pozitën e punës “Gjeodet”, në Drejtorinë e Financave dhe Pronës, në Komunën e Prishtinës, me koeficient (5) të pagës. Ndërsa, si rezultat i Vendimit të datës 19.01.2016, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësitë dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Publike, me datë 01.02.2017 ankuesi është sistemuar nga pozita Gjeodet në pozitën Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme, në kuadër të Komunës së Prishtinës, më gradë të pagës 11, me ç ‘rast ankuesit i është lëshuar edhe Akt emërimi me numër 01 Nr.112-817. Ankuesi kundër këtij sistemimi, pasi ka shterur procedurat e brendshme të ankesës në Komunën e Prishtinës, ndërsa, i njëjta më datë 02.06.2017, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit të datës 05.05.20217 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, më të cilën kishte refuzuar ankesën e ankuesit për kundërshtim të sistemimit, ndërsa, Këshilli më Vendimin A 02/314/2017, të datës 21.07.2017, ka shfuqizuar si të paligjshëm Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, duke e obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës, të bëjë rishqyrtimin e sistemimit të anketuesit, vendim të cilën Kryetari i atëhershëm i Komunës së Prishtinës, nuk e kishte zbatuar dhe si pasojë ankuesi ka ushtruar pozitën Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme deri më datë 21.08.2024, ku me c’rast Kryetari i Komunës së Prishtinës, më Vendimin me numër 14-101/03-109913/24, të datës 21.08.2024, ka bërë zbatimin e Vendimit A 02/314/2017, të datës 21.07.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e sistemuar ankuesin nga pozita “Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme” në pozitën “Zyrtar për Tatim në Pronë dhe si pasojë e kësaj, ankuesi dhe Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës më datë 12.09.2024, kanë nënshkruar Akt Emërimit me numër Nr.01-112-837/2024, për pozitën “Zyrtar i Tatimit në Pronë”, me klasë dhe koeficient GJ33-5.1.

Ankuesi më datë 30.01.2025 ka parashtruar kërkesë tek Sektori i Burimeve Njerëzore, me të cilën ka kërkuar kompensimin e diferencës së pagës në mes të gardës 9 dhe 11, për periudhën nga data 01.02.2017 deri më datë 31.12.2022, dhe nga data 01.01.2023 deri më datë 21.08.2024, kompensimin e dallimit mes koeficientit GJ.41-4.0 dhe koeficientit Gj.33-5.1, ndërsa, Sektori i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës më datë 04.02.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-117/01-15936/25, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit duke konstatuar se sipas vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është paraparë kompensim.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.14-117/01-0125241/24 të datës 04.02.2025, të Sektorit të Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, pretendon se institucioni e ka dëmtuar në gradë duke kërkuar kompensimin material nga grada 9 në gradën 11, nga data 01.02.2017 deri më datë 31.12.2022 dhe nga data 01.01.2023 deri më datë 21.08.2024 nga koeficienti 4 në atë 5.1.

Në kuptim të bazueshmerisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, dhe duke qenë se objekti i ankesës i referohet dëmit material të ankueses i pasuar si rezultat i ristrukturimit të institucionit, sipas Vendimit të datës 19.01.2016 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësitë dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Publike, Kolegji i Këshillit nuk ka shqyrtuar ligjshmërinë e ristrukturimit të ankuesit sipas këtij vendimi, sepse Këshilli me Vendimin A 02/314/2017, të datës 21.07.2017, e kishte konsideruar jo të ligjshëm sistemimin e ankuesin dhe lenden e kishte kthyer për rishqyrtim, mirëpo, Kolegji trajtoj pretendimet për dëmtim të ankuesit në kuptim të pagës, dhe si rrjedhojë e analizimit të provave materiale të çështjes Kolegji konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e kompensimit të diferencës së pagës në mënyrë retroaktive nga data 01.02.2017 deri më datë 31.12.2022, ndërmjet gradës 11 dhe 9, mbi faktet se sipas listave të pagave të përcjella nga organi punëdhënës del se ankuesi për pozitën gjeodet ka realizuar pagë bruto në vlerë prej 340.30 uro, kurse për pozitën Zyrtar për Evidentimin e Pronave të Paluajtshme ka realizuar pagë bruto në vlerë prej 372.36, pra ankuesi nuk ka pësuar dëm material në kuptim të përfitimit të pagës. Ndërsa, më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, gjegjësisht nga muaji shkurt deri dhjetor 2023 ankuesi ka realizuar koeficient 4 të pagës, pagë bazë prej 420 (Koeficienti 105 euro) ndërsa, për periudhën janar –shtator ka përfituar pagë bazë në vlerë prej 440 (koeficienti 110 euro). Kurse nga tetori 2024 si rezultat i Vendimit me numër 14-101/03-109913/24, të datës 21.08.2024, të Kryetarit të Prishtinës, ankuesi realizon pagë bazë me koeficient 5.1, në vlerë prej 561 euro. Andaj, mbi bazën e këtyre fakteve rrjedhë nuk ka mbështetje pretendimi për kompensimin e diferencës së pagës në mes koeficientit GJ.41-4.0 dhe koeficientit Gj.33-5.1, për periudhën data 01.01.2023 deri më datë 21.08.2024, sepse ankuesi siç u tha me lartë gjatë kësaj kohe ka ushtruar pozitën Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme, dhe se paga e përcaktuar për këtë periudhë ka qenë si rezultat i procesit të ekuivalentimit të koeficienteve sipas Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës, ku në pikën 1 përcaktohet: *1. Miratohet ekuivalenca e sistemit të vjetër me sistemin ri të klasifikimit të koeficientëve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë për të punësuarit në sektorin publikë sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, për të cilët është i nevojshëm procesi i klasifikimit të vendeve të punës; 2. Ekuivalenca sipas pikës 1 të këtij vendimi është propozuar nga Ministria e Punës të Brendshme dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe bashkëngjitet si shtojca 1 e këtij vendimi dhe 3. Obligohet Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që në vazhdimësi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi t'i korrigjojnë/përshtatin të dhënat e të punësuarve në sektorin publikë sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, ex officio dhe sipas kërkesave të institucioneve.* Pra, mbi gjendjen e këtyre fakteve korrigjimi dhe aplikimi retroaktiv i koeficientit 5.1 në raport me ankuesin është ligjërisht i pamundur, sepse ankuesi ende ka pas në fuqi Aktin e Emërimit 01 Nr.112-817, dhe si rrjedhojë ka ushtruar pozitën e emërimit sipas këtij akti, ndërsa, koeficienti 5.1 aplikohet për pozitë sipas Akt emërimit Nr.01-112-837/2024, të datës 12.09.2024 dhe si i tillë nuk ka efekte prapavepruese.

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më sipër si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.403/2025

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, N. Z.;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së